



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA  
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Nr.regj. 62586/12

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË, DEPARTAMENTI I PERGJITHSHËM, Divizioni i Kundërvajtjes** duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Ismet Bogujevci, nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 7 e ndëshkuar sipas neni 17 par. 1 al.1.2 të Ligjit Nr. 04/L-050, për Deklarimin, Prejardhjen, dhe Kontrollimin e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat Zyrtar, e në bazë të nenit 73,74, si dhe neni 198 al.1 të Ligjit mbi kundërvajtje, me dt. 03.10.2013 merrë këtë:

### AKTVENDIM

**PEZULLOHET** procedura kundërvajtëse kundër të pandehurit Ismet Bogujevci, nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 7 e ndëshkuar sipas neni 17 par. 1 al.1.2 të Ligjit Nr. 04/L-050, për Deklarimin, Prejardhjen, dhe Kontrollimin e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat Zyrtar.

Pezullimi bëhet konform neni 198 al.1 të LMK-ës, se bëhet fjalë për veprim që nuk është përcaktuar si kundërvajtje, konform neni 3 të Ligjit nr. 04/L-050, ushtrues i detyrës së Drejtorit nuk është i përkufizuar në emërtimin se është i obliguar ta paraqesë pasurinë në AAK.

Shpenzime të procedurës nuk ka patur.

Nga një ekzemplar të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

### Arsyetim

Agjensia Kundër Korrupsionit, parashtroi kërkesën nr.01-4252/12, të dt 29.11.2012, për zhvillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të lartëpermendurit dhe për kundërvajtjen e lartcekur, ku u muar edhe konkluzion..

Në bazë të kërkesës, u dëgjua i pandehuri Ismet Bogujevci i cili deklaroi se, me rastin e pranimit të detyrës si ushtrues i Detyrës së drejtorit të Ansambllit Kombëtar të këngëve dhe valleve "Shota", jam emëruar në bazë të aktvendimit të dt. 04.05.2012, të nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm Veton Fierzi. Unë nuk kam qenë i informuar nga personeli i Ministrisë,që jam person, i cili jam i obliguar ta paraqes pasurinë, po ashtu nuk kam pranuar kurrfarë formulari për deklarimin e pasurisë, as fizikisht e as përmes email-it, por, pas 5 muajve, nga zyrtarët e personelit, më është dërguar emri im se jam i obliguar ta paraqes pasurinë, ku shihet edhe nga shkresat e lëndës, se me dt. 03.10.2012, është njoftuar Agjensionin dhe kam shkuar në Agjension,e kam plotësuar formularin për deklarimin e pasurisë, por,vërtetimin se e kam deklaruar pasurinë, nuk po më kujtohet se a e kam marrë. Pranimi i kësaj detyre është bërë me marrëveshje që kjo pozitë të zgjatë dy ose tre muaj, ose, deri sa të dalë konkursi i rregullt për Drejtor të Përgjithshëm. Dua të potencoj edhe një çështje në përkufizimin e Ligjit mbi deklarimin e pasurisë, se në neni 3 nuk është e potencuar askund se, ushtrues detyrash të drejtorit, janë te obliguar ta paraqesin pasurinë sipas këtij ligji, prandaj në rastin konkret mungon parimi i legalitetit të ndjekjes dhe mund të them se, nga pika jonë kontaktuese, kur e ka dërguar emrin tim në AKK dhe të njëjtat kanë bërë shkelje ligjore me rastin e dërgimit e emrit tim dhe kërkesës për deklarimin e pasurisë, kërkoi nga Gjykata që ta hudhe poshtë këtë kërkesë të pabazuar dhe e kundërshtoi në përgjithësi si të paarsyeshme.

Emri		
Detyra		
Grup	DPK/DMP	
Nr. i aktit		03-3607/13
Emri i drejtorit	02	
Emri i gjyqtarit		29.10.2013

03-3607/13/02  
aug

Për vërtetimin e gjendjes faktike u dëgjua dëshmitarja Afërdita Veliu, zyrtare e personelit në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe pika kontaktuese me Agjensionin kundër Korrupsionit. Në rastin konkret është fjala për Ismet Bogujevcin, i cili është emëruar ushtrues i detyrës në AKV "Shota", në vend të Dilaver Kryeziut, i cili është emëruar me dt. 04.05.2012. Sa i përket rastit, dua të theksoj se pala me rastin marrjes se detyrës, nuk është njoftuar me kohë, të cilën gjë e vërtetojnë edhe shkresat e lëndës, të cilat shihen se i kemi dorëzuar Agjensionit, emrat e Ismet Bogujevcit dhe dy personave tjerë, me dt. 26.09.2012, të cilës ia kemi drejtuar përmes email-it zyrtares Ajnishahe Leka, gjegjësisht në AKK, që të njëjtit t'ia dërgojnë formularin për deklaram të pasurisë. Dilemat të cilat kanë qenë për mos njoftimin e Agjensionit me emrat e këtyre personave, kanë qenë për arsye se, nuk e kemi patur të qartë se, si ushtrues i detyrës se Drejtorit, a është i obliguar ta paraqesë pasurinë, pasi që në nenin 3 të Ligjit nr. 04/L-050, kjo kategori nuk është e përkufizuar si kategori për deklarimin e pasurisë, por, në konsultim me Agjensionin, na është thënë se kjo kategori është e obliguar të deklarojë pasurinë e tyre, ku edhe i kemi dërguar emrat e këtyre personave, të cilët formularë i kam pranuar në mënyrë elektronike dhe në të njëjtën mënyrë ia kam dërguar palës, në fund të muajit shtator.

U dëgjua edhe parashtruesi i kërkesës Agron Behrami, i cili deklaroi se, sa i përket kërkesës që e kemi ushtruar ndaj palës Ismet Bogujevci, për kundërvajtje nga neni 7 i Ligjit nr. 04/L-050, kemi të bëjmë me deklarim me rastin e marrjes së detyrës së Zyrtarit të Lartë Publik, i cili ishte zgjedhur në bazë të vendimit të Ministrisë së Kulturës, si ushtrues i detyrës së AKVK "Shota", i cili vendim ishte marrë me dt. 04.05.2012. Punëtorja Ajnishahe Leka kishte kërkuar nga pika kontaktuese e kësaj Ministrie, se a ka ndryshime të personave që janë të obliguar ta paraqesin pasurinë në AAK dhe të nesërmen me dt. 26.09.2012, është sjellur lista, nga pika konstatuese e kësaj Ministrie, që në njërin nga emrat, ishte edhe Ismet Bogujevci, të cilën e kishte dërguar Afërdita Veliu, e të cilën listë e kemi pranuar në Agjension me dt. 03.10.2012. Nga kontrollimi i librave të protokolleve ku evidentohen të gjithë personat që deklarojnë pasurinë, ky person nuk ka qenë në listën e personave zyrtar që deklarojnë pasurinë brenda afatit ligjor, i cili ka qenë i paraparë të deklarojë deri me dt, 04.06.2012, pasi që deklarimi i pasurisë për këtë kategori është 30 ditë nga dita e pranimit të detyrës, ndërsa për vonesat të cilat janë bërë nga pika kontaktuese e Ministrisë dhe mos njoftimi i palës për këtë obligim, është e përcaktuar me nenin 4 se si informohen Zyrtarët e lartë Publik, që pika kontaktuese është e obliguar që ti informojë. Në përkufizimin e nenit 3 janë të specifikuar të gjithë personat që janë të obliguar ta paraqesin pasurinë, ndërsa ushtrues të detyrës së Drejtorit, e përkufizon në nenin 3 pika 1.11 të gjitha pozitat e drejtorëve të Departamenteve dhe Shefat e Prokurimeve Publike.

Andaj Gjyqtari pas administrimit të provave dhe të provuarit të kësaj çështje, me të drejtë dhe në mënyrë të plotë, vërtetoi gjendjen faktike, se personi nuk e ka kryer kundërvajtjen e lartëcekur, konform nenit 198 al. 1 të LMK-së e PEZULLOI procedurën kundërvajtëse se në rastin konkret kemi të bëjmë me fjala është për veprim që nuk është përcaktuar si kundërvajtje, bazuar në nenin 3 të Ligjit 04/L-050, ku nuk është e paraparë kjo kategori e ushtruesëve të detyrës së drejtorëve, që janë obliguar ta paraqesin pasurinë e tyre, të paraparë sipas këtij Ligji.

Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, Divizioni i Kundërvajtjes

Gjyqtari

Fatmir Behrami

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, palët mund të ushtrojnë ankesë, në Gjykatën e Apelit – Divizioni i Kundërvajtjes në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh pas pranimit të të njëjtit, përmes këtij Divizioni.